

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Frosina Sylejmani dhe Zenel Leku anëtarë, në çështjen juridike të paditësve K.L., B.L., F.L., E.L., A.L., M.L., Sh.L., A.L.1, S.L., B.L.1 dhe B.L.2, nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, të cilët i përfaqëson me autorizim A.L.2, avokat në Prishtinë, kundër të paditurave NN, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson V.H. dhe Kompania e Sigurimeve “NN1”, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim F.A, në çështjen për kompensim dëmi, vlera e kontestit 130.000.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN1”, dhe ankesën e të paditurës “NN1”, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1986/08 të datës 10.04.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **16.02.2018**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET si e themeltë** ankesa e të paditurës, Kompania e Sigurimeve “NN1”, me seli në Prishtinë **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1986/08 të datës 10.04.2013 në pjesën aprovuese të dispozitivit, sa i përket obligimit që të paditurat detyrohen në mënyrë solidare në pagesën e dëmit, ashtu që gjykon **REFUZOHET** kërkesëpadia paditësve K.L., B.L., F.L., E.L., A.L., M. L., Sh.L., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN1”, me seli në Prishtinë, që paditësve për shkak të vdekjes së N.L., si pasojë e aksidentit më datë 17.08.2007, në oborrin e Ndërmarrjes “Y”, në ..., tu paguajë, si vijon: Paditëses K.L.: për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së bashkëshortit shumë prej 9.000.00 €. Paditësve B., F. dhe E.L.: për dhimbje shpirtërore vdekjen e babait, secilit veç e veç, shumë prej 6.000.00 €. Paditësit A.L.: për dhimbje shpirtërore për vdekjen e babait shumë prej 3.000.00 €. Për mbajtjen e humbur- rentën për paditësen K.L. dhe fëmijët e mitur, B., F., E. dhe A.L., për periudhën nga dita e aksidentit të ndjerit N.L. me datë 17.08.2007 e deri më datë 30.11.2012, t’ua paguajë shumë 17.837.50€, kamatën në shumë prej 1.601.45€, gjithsej shumë 19.438.95€, kurse për të ardhmen nga data 01.12.2012 e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj nga 282.30€. Paditësve M.L. dhe Sh.L.: për dhimbje shpirtërore të vdekjes së djalit të tyre, secilit nga 6.768.00€, sikundër që të gjithë këtyre paditësve si më lartë, t’ua paguajnë kamatën në lartësi prej 12%, me interes vjetor prej datës 01.08.2011, për kërkesën në dhimbje shpirtërore e deri në pagesën e tërësishme, ndërsa për kërkesën për mbajtjen e humbur- rentën, të paguajnë kamatën 12%, nga data 01.12.2012 e tutje si dhe shpenzimet procedurës në shumë 2.242.00 €, **si e pa bazuar**.

**REFUZOHET si e pa themeltë** ankesa e të paditurës “NN”, me seli në Prishtinë, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1986/08 të datës 10.04.2013, në raport me të paditurën NN, me seli në Prishtinë **VËRTETOHET**, ndërsa pjesa që ka të bëjë me kamatën **NDRYSHOHET**, ashtu që gjykon dhe duhet të jetë: për shumën e gjykuara për dëmin jomaterial si në dispozitiv të aktgjykimit të vërtetuar, me kamatë

e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 01.08.2011, e deri në pagesën definitive, si dhe për rentën (për pjesën që nuk është llogaritur kamata nga 01.12.2012) nga data e arritjes për pagesë të secilës ratë e deri në pagesën definitive.

Në pjesën refuzuese aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1986/08 të datës 10.04.2013, mbetet i pa shqyrtuar.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1986/08, 10.04.2013, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve K.L., B.L., F.L. E.L., A.L., M.L., Sh.L., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, Detyrohen të paditurit NN në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “NN1”, në Prishtinë, që paditësve për shkak të vdekjes së N.L., si pasojë e aksidentit më datë 17.08.2007, në oborrin e Ndërmarrjes “Y”, në ..., tu paguajë, si vijon: Paditëses K.L.: për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së bashkëshortit shumë prej 9.000.00 €. Paditësve B., F. dhe E.L.: për dhimbje shpirtërore vdekjen e babait, secilit veç e veç, shumë prej 6.000.00 €. Paditësit A.L.: për dhimbje shpirtërore për vdekjen e babait shumë prej 3.000.00 €. Për mbajtjen e humbur- rentën për paditësen K.L dhe fëmijët e mitur, B., F., E. dhe A.L., për periudhën nga dita e aksidentit të ndjerit N.L. me datë 17.08.2007 e deri më datë 30.11.2012, t’ua paguajë shumë 17.837.50 €, kamatën në shumë prej 1.601.45 €, gjithsej shumë 19.438.95 €, kurse për të ardhmen nga data 01.12.2012 e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj nga 282.30 €. Paditësve M.L. dhe She.L.: për dhimbje shpirtërore të vdekjes së djalit të tyre, secilit nga 6.768.00 €, sikundër që të gjithë këtyre paditësve si më lartë, t’ua paguajnë kamatën në lartësi prej 12%, me interes vjetor prej datës 01.08.2011, për kërkesën në dhimbje shpirtërore e deri në pagesën e tërësishme, ndërsa për kërkesën për mbajtjen e humbur- rentën, të paguajnë kamatën 12%, nga data 01.12.2012 e tutje si dhe shpenzimet procedurës në shumë 2.242.00 €. Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumën e gjykuar, në paragrafi një të dispozitivit dhe atë: për dhimbje shpirtërore për paditësit B., F., E.L., mbi shumë e gjykuar për secilin nga 6.000.00 €, e deri në shumë e kërkuar për secilin nga 9.000.00 €, për paditësin A. mbi shumë e gjykuar 3.000.00 €, e deri në shumë e kërkuar 9.000.00 €, për paditësit M.L. dhe Sh.L., mbi shumë e gjykuar për secilin nga 6.738.00 €, e deri në shumë e kërkuar për secilin nga 8.000.00 €, për paditësit- vëllezërit e të ndjerit N.L dhe atë: A1, S., B.1 dhe B.L.2, shumë e kërkuar secili nga 5.000.00 €, të gjithë paditësve për shpenzime të varrimit 2.500.00 €, dhe për ngritje të përmendores 1.500.00€.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “NN1”, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vendimit mbi kamatën dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të merr aktvendim që të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1986/08, të datës 10.04.2013, dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohet aktgjykimi dhe Gjykatës së shkallës së dytë të vendos vetë lidhur me kërkesëpadinë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur edhe e paditura “NN”, me seli në Prishtinë, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykatat e Apelit të aprovojë këtë ankesë si të bazuar, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1986/08 të datës 10.04.2013, ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje, konform dispozitave ligjore të nenit 195, pika c), e LPK-së, apo ta ndryshojë ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëlojë dhe të njëjtin aktgjykim ta ndryshon dhe ta gjykojë shumën dukshëm më të ulët duke u bazuar në nenin 195.1, pika e) e LPK-së. Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësve, duke propozuar që të refuzohen ankesat e të paditurave dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

**-Ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN1”, në Prishtinë, është e themeltë.**

**-Ankesa e të paditurës “NN”, me seli në Prishtinë, është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit kanë paraqitur padi me datë 29.10.2008, ndaj të paditurave, me kërkesë për kompensim dëmi, me propozim që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësve si e bazuar. Përgjigje në padi, kanë paraqitur të paditurat Kompania e Sigurimeve “NN1” dhe “NN”, me seli në Prishtinë, duke e kontestuar kërkesëpadinë si të pa bazuar, që të dyja kanë kontestuar obligimin e tyre për kompensimin e dëmit në raport me paditësit. Më datë 21.12.2012, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur parashtrësë për rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadiës.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave, ku bëri leximin e raportit të policisë të datës 17.08.2007, aktvendimin penal të Gjykatës së qarkut në Prishtinë, të datës 03.03.2009, P.nr.12/06, procesverbalin e hartuar nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, 59-3/2007, të datës 02.05.2008, certifikatën e mjekut, fletë vdekja me nr. amzë 398, lëshuar nga QKUK- Klinika e anastologjisë dhe mjekimit intenziv dhe vërtetimi për vdekjen për vdekjen e Nexhat Lecit, certifikata e vdekjes e datës 26.09.2007, certifikata e martesës të ndjerit Nexhat Lecit me Kimete Visoka- Leci, të datës 01.10.2012, deklarata për bashkësinë familjare, të datës 10.06.2008, certifikata e lindjes për fëmijët e të ndjerit A., E., F., B.L., certifikata e martesës së prindërve të të ndjerit, M.L dhe Sh.L, të datës 01.10.2012, certifikata e lindjes së vëllezërve të të ndjerit, A.L.1, S.L., B.L.1 dhe B.L.2. Dokumentacioni i të ndjerit lidhur me përgatitjet profesionale, vërtetimi i lëshuar nga Ndërmarrja “Y”, SH.P.K, të datës 19.06.2008, vërtetimet e lëshuara nga Shkolla e mesme e ulët “Ali Kelmendi”, në ..., për fëmijët e të ndjerit dhe ekspertiza e ekspertit A.B3, e datës 16.11.2012, prandaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, në pajtim me dispozitat ligjore, Rregullit 3, nenin 2 dhe 4 par.1 prej pikës a) deri në pikën g), mbi ndryshimin e rregullit për sigurime të detyrueshme të auto përgjegjësisë, neneve 188, 193, 201 të LMD-së, dhe nenin 26 par.6 të Ligjit nr.04/L-018, për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, ndërsa sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale, gjykata është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon pjesërisht vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Por kjo gjykatë vlerëson se me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të atakuar ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, Rregullit 3, nenin 2 dhe 4 par.1 prej pikës a) deri në pikën g), mbi ndryshimin e rregullit për sigurime të detyrueshme të auto përgjegjësive, sa i përket vendosjes që të paditurat të detyrohen në mënyrë solidare ti kompensojnë dëmin paditësve, si dhe nenin 26 par.6 të Ligjit nr.04/L-018, për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, lidhur me caktimin e lartësisë së kamatës, për të cilat arsye gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, të parashtruara nga palët, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit pasi ka vlerësuar pretendimet ankimore të palëve të paditura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN1”, me seli në Prishtinë, pasi vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti ndonëse ka qenë e siguruar te kjo e paditur dhe ka pasur mbulesë siguroese, nëse e marrim parasysh Rregullin 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive, të nxjerrë nga Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, datë 20 janar, 2006, në nenin 4 par.1, pika e), (i aplikueshëm në rastin konkret) ka përcaktuar se “mjetet nga fondi garantues do të përdoren për pagesën e dëmeve të shkaktuara: (pika e) nga përdorimi automjetit të përdorur pa autorizim nga personi që ka marrë në posedim në kundërshtim me ligjin dhe rregullat” që në rastin konkret përmbushen të gjitha kushtet për aplikimin e kësaj dispozite, pasi personi i cili ka vozitur automjetin ka qenë person i moshës së mitur dhe nuk ka mundur të ketë as pëlqimin dhe as autorizimin për të vozitur, fakt që është vërtetuar edhe nga aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, PM.nr.12/06, të datës 03.03.2009, i marrë në çështjen penale të zhvilluar ndaj të miturit i cili e ka shkaktuar aksidentin. Bazuar në këtë dispozitë të lartcekur përgjegjësia për kompensimin e dëmit në raport me paditësit për aksidentin e shkaktuar të datës 17.08.2007, si pasoj e të cilit ka vdekur N.L., (fakt i cili nuk është kontestues), është ekskluzivisht e të paditurës “NN”, me seli në Prishtinë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në raport me të paditurën “NN”, me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë shumat e gjykuara të aprovuara për shkak të dhimbjeve të shkaktuara nga vdekja e bashkëshortit, babait, birit, të paditësve në aksidentin të komunikacionit të datës 17.08.2007, kanë përjetuar vuajtje shpirtërore të intensitetit të lartë, që është e natyrshme me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, pastaj vuajtja shpirtërore ka kaluar me një intensitet më të ulët e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite, po ashtu gjykata me rastin e aprovimit pjesërisht të kërkesëpadisë dhe vendosjes lidhur me lartësinë e dëmit jo material, ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 200 dhe 201 par. 1 të LMD-së<sup>1</sup>, si dhe nenit 323 të LPK-së, në bazë të cilave dispozita ekziston e drejta e kompensimit të paditësve në raport me të

<sup>1</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

paditurën, për dëmin e shkaktuar, dhimbjeve shpirtërore me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të shumave si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, ka marrë parasysh të mirën e dëmtuar, duke marrë për bazë të gjitha rrethanat, raportin familjar, pasojat dhe përjetimet që kanë përjetuar paditësit pas vdekjes së të ndjerit.

Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket fitimit të humbur-rentës për paditësen K.L. dhe fëmijët e mitur, B., F., E. dhe A.L., për periudhën nga dita e aksidentit të ndjerit N.L. me datë 17.08.2007 e deri më datë 30.11.2012, t'ua paguajë shumën 17.837.50 €, kamatën në shumë prej 1.601.45 €, gjithsej shumën 19.438.95 €, kurse për të ardhmen nga data 01.12.2012 e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj nga 282.30€, respektivisht deri me datë 29.08.2023, kur i ndjeri N.L. do të duhej të pensionohej sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës 65 vjeçare, pasi konsideron se ekspertiza aktuaristike e datës 16.11.2012, e punuar nga eksperti A.B.3, është e plotë, ka marrë për bazë të gjithë parametrat, ndaj të njëjtës ekspertizë nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga pala e paditur, e cila vërejtje do të vinte në dyshim validitetin e saj.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të gjithë paditësve, t'ua paguajnë kamatën në lartësi prej 12%, me interes vjetor prej datës 01.08.2011, për kërkesën në dhimbje shpirtërore e deri në pagesën e tërësishme, ndërsa për kërkesën për mbajtjen e humbur-rentën, të paguajnë kamatën 12%, nga data 01.12.2012 e tutje, të cilën qëndrim kjo gjykatë nuk e pranon, pasi në rastin konkret nuk ka mundur të aplikohet ligji nr. 04/1-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, përkatësisht neni 26 par.6, të këtij ligji pasi i njëjti nuk ka qenë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit, ashtu që si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, aktgjykimi i atakuar është ndryshuar ashtu që duhet të jetë: për shumën e gjykuara për dëmin jomaterial si në dispozitiv të aktgjykimit të vërtetuar, me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 01.08.2011, e deri në pagesën definitive, si dhe për rentën (për pjesën që nuk është llogaritur kamata nga 01.12.2012) nga data e arritjes për pagesë të secilës ratë e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së<sup>2</sup>.

Gjykata e Apelit nuk është lëshuar në arsyetimin e shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese, lidhur me vendosjen për kërkesëpadinë, pasi pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa pala e paditur nuk ka interes juridik për atakimin e aktgjykimit në këtë pjesë.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë lidhur me shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke i arsyetuar të njëjtat.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

---

<sup>2</sup> Njëjtë,

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3988/2013, më datë 16.02.2018**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
*Fejzullah Rexhepi*